V E N D I M
Nr.549, datë 28.8.1998

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.473, DATË 3.10.1994 "PËR PROKURIMIN ME SIPËRMARRJE TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË FUNERALIT, MIRËMBAJTJES SË SIPËRFAQEVE TË GJELBËRTA, DEKORIT DHE VARREZAVE PUBLIKE TË DËSHMORËVE", NDRYSHUAR ME VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.586, DATË 5.12.1994

Në mbështetje të nenit 36 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe të Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.473, datë 3.10.1994, ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.586, datë 5.12.1994, në pikën 8, shfuqizohen fjalët "dhe për qytetin e Tiranës edhe mirëmbajtja e parqeve dhe e sipërfaqeve të gjelbërta".

2. Bashkia e Tiranës, nëpërmjet ndërmarrjes së gjelbërimit të administrojë dhe të trajtojë me shërbime objektet e karakterit kombëtar si: Varrezat e Kombit, Parkun e Madh dhe Kopshtin Zoologjik.

3. Mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbërta në qytet, e veprave ndërtimore e ujore, si dhe sektori i prodhimit të bimësisë dekorative të kalojë në sipërmarrje, sipas dispozitave në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTR
Fatos Nano